

VENDIMI ESHTË I PLOTËSISHTË  
DOLLKAVE PRAYNORSHAT  
GJYKATA THEMELORE / OSN  
FERIZAJ / UROSHVAC

PKR. nr. 172/17

NË EMËR TË POPULLIT

20.03.2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL,** me Gjyqtarin e vetëm gjykues Agim Maliqi dhe

zyrtare ligjore Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale “Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve” nga neni 399 par. 1 nënpar.1.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP. nr. 1848-7/16 e datës 19.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 20 shkurt 2017, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Shukri Jashari dhe të pandehurit, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 24.02.2017, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i lindur më dt. [REDACTED] në [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna e [REDACTED] i punësuar në “[REDACTED]” – fsh. [REDACTED], ka të kryer shkollimin e lartë – drejtimi Informatikë në Universitetin [REDACTED] “[REDACTED]”, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED]

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datë 22.09.2016, rreth orës 11:20, në rrugën “[REDACTED]” në [REDACTED], afër [REDACTED] me rastin e kontrollës nga ana e policisë është vërtetuar se në automjetin e markës “Reno Laguna”, ngjyrë hiri metalike me numër të shasisë VF1KG12BB3652122, me qëllim të shmangët taksave doganore, pa autorizim kishte vendosur targat e regjistrimit me nr. [REDACTED], të cilat i përkisnin automjetin tjetër pasi për këtë automjet nuk ishin paguar obligimet doganore dhe i njëjti i dorëzohet Doganës së Kosovës,

me të cilën ka kryer veprën penale “Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve” nga neni 399 par. 1 nënpar.1.5 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë nenit 399 par.1 nënpar.1.5 dhe neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPP-ës, e

**G J Y K O N**

**ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3 /TRE/ MUAJ, i cili dënim nuk do të ekzckutohet nëse i akuzuari për I/NJË/VIT pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.**

**Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 /pesëdhjetë/€ në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.**

**Konform nenit 69 par.1 të KPRK-së, konfiskohen tabelat e regjistrimit nr. D**

#### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me aktakuzën e evidentuar PP. nr. 1848-7/16 e datës 19.01.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale "Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve" nga neni 399 par. 1 nënpar.1.5 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 20 shkurt 2017, në të cilën shqyrtim i akuzuari u deklarua fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza.

Prokurori i shtetit Shukri Jashari, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të pandehurit gjatë procedurës paraprake, formulari i inventarizimit të automjetit i dt.22.09.2016, vërtetimi i konfiskimit të sendeve –veturës të tipit Renault Laguna, çelësit të veturës dhe targave të regjistrimit si dhe fotografive të automjetit dhe targave të regjistrimit.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjykata, konform nenit 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale "Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve" nga neni 399 par. 1 nënpar.1.5 të KPRK-së. meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi ka vendosur tabelat e regjistrimit [REDAKTUAR] në automjetin e tipit Reno Laguna e që këto tabela ishin të përkohshme dhe i përkisnin një automjeti tjetër.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale. deri më tani nuk rezulton se është dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale se është i moshës relativisht të re, i martuar baba i një fëmije, kurse në rastin konkret nuk gjeti rrethanë rënduese pos që vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e caktuar, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuara është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/€. bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20/njëzet/€, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR.nr. 172/17 datë 24.02.2017.**

Zyrtare ligjore,

Albana Ajvazi

Gjyqtarin e vetëm gjykues,

Agim MALIQI

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.